



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:095100

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05673614

C.nr.360/2021

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm\ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësve: L. M.-P. nga fshati D./Malishevë, R. P. nga fshati D./Malishevë, S.P. nga fshati D./Malishevë, D.P. nga fshati D./Malishevë dhe A. S. nga fshati J./Malishevë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Emrush Kastrati avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik i komunës Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike “Kompensim për shpenzimet e udhëtimit”, vlera e kontestit 1,908.90 €, jashtë seancës gjyqësore me datë 13.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësve L. M.-P. nga fshati D./Malishevë, R. P. nga fshati D./Malishevë, S.P. nga fshati D./Malishevë, D.P. nga fshati D./Malishevë dhe A. S. nga fshati J./Malishevë, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, t`ua paguaj të gjithë paditësve shumën e përgjithshme prej **1,908.90 euro** dhe atë për secilin paditës shumat si në vijim:
1. Paditëses **L.M.-P.** shumën prej **381.50 euro** dhe atë për udhëtim nga vendbanimi i saj nga fshati D. e deri në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, për periudhën 2017 deri 31.12.2020 ose për gjithsejtë 545 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (1 euro bileta vajtje-ardhje) pra 0.70 euro x 545 ditë pune = 381.50 euro.
 2. Paditësit **R. P.** shumën prej **381.50 euro** dhe atë për udhëtim nga vendbanimi i tij nga fshati D. e deri në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, për periudhën 2017 deri 31.12.2020 ose për gjithsejtë 545 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (1 euro bileta vajtje-ardhje), pra 0.70 euro x 545 ditë pune = 381.50 euro
 3. Paditëses **S.P.** shumën prej **289.80 euro** dhe atë për udhëtim nga vendbanimi i saj nga fshati D. e deri në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, për periudhën 2017 deri 31.12.2020 ose për gjithsejtë 414 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë

pune, në 70% të biletës (1 euro bileta vajtje-ardhje) pra $0.70 \text{ euro} \times 414 \text{ ditë pune} = 289.80 \text{ euro}$.

4. Paditëses **D. P.** shumën prej **93.10 euro** dhe atë për udhëtim nga vendbanimi i saj nga fshati D. e deri në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, për periudhën 2017 deri 31.12.2020 ose për gjithsejtë 133 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (1 euro bileta vajtje-ardhje) pra, $0.70 \text{ euro} \times 133 \text{ ditë pune} = 93.10 \text{ euro}$ dhe
 5. Paditësit **A. S.** shumën prej **763.00 euro** dhe atë për udhëtim nga vendbanimi i tij nga fshati J.e deri në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, për periudhën 2017 deri 31.12.2020 ose për gjithsejtë 545 ditë pune, të përlllogaritur nga 1.40 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (2 euro bileta vajtje-ardhje) pra $1.40 \text{ euro} \times 545 \text{ ditë pune} = 763.00 \text{ euro}$, për të gjithë paditësit me kamatë ligjore prej 8% që nga data e paraqitjes së padisë me datë 14.05.2021 dhe të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.
- II. **OBLIGOHET** e paditura që paditësve t’ua kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 342.00 euro nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përbarimit ligjor, dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 312.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësit L. M.-P. nga fshati D./Malishevë, R. P. nga fshati D./Malishevë, S.P. nga fshati D./Malishevë, D.P. nga fshati D./Malishevë dhe A. S. nga fshati J./Malishevë të cilët sipas autorizimit në shkresat e lëndës i përfaqëson Emrush Kastrati avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 14.05.2021 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit. Sipas padisë, paditësit janë të punësuar në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë si mësimdhënës të rregullt të lëndëve përkatëse, ashtu që me rregull dhe me kohë i kanë kryer të gjitha detyrimet si mësimdhënës.

I autorizuari i paditësve në padi dhe në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 15.03.2024, ka theksuar se:

Paditësja L. M.-P. për periudhën prej vitit 2017 deri 31.12.2020 i ka gjithsejtë 545 ditë pune dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 381.50 euro ($0.70 \times 545 \text{ ditë} = 381.50 \text{ euro}$).

Paditësi R. P. për periudhën prej vitit 2017 deri 31.12.2020 i ka gjithsejtë 545 ditë pune dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 381.50 euro ($0.70 \times 545 \text{ ditë} = 381.50 \text{ euro}$).

Paditësja S. P., për periudhën prej vitit 2017 deri 31.12.2020 i ka gjithsejtë 414 ditë pune dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 289.80 euro ($0.70 \times 414 \text{ ditë} = 289.80 \text{ euro}$).

Paditësja D. P., për periudhën prej vitit 2017 deri 31.12.2020 i ka gjithsejtë 133 ditë pune dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 93.10 euro (0.70 x 133 ditë = 93.10 euro) dhe

Paditësi A. S., për periudhën prej vitit 2017 deri 31.12.2020 i ka gjithsejtë 545 ditë pune dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 763.00 euro (1.40 x 545 ditë = 763.00 euro).

Ka shtuar se detyrimi i të paditurës ndaj paditësve ka lindur me krijimin e bazës juridike prej datës 18.04.2017 kur edhe është nënshkruar Kontrata Kolektive, andaj ka kërkuar nga gjykata të aprovohet kërkesëpadia e paditësve dhe të detyrohet Komuna e Malishevës-Drejtoria e Arsimit që paditësve t'ua kompensoj shumat e lartcekura, me kamatë ligjore prej 8% sipas dispozitave ligjore të LMD-së, dhe po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës aq sa do të shkaktohen në këtë çështje juridike.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të datës 15.03.2023, ndër të tjera ka theksuar paditësit nuk e kanë specifikuar periudhën e pagesës së këtyre mjeteve, pastaj kërkesa e paditësës është në kundërshtim me kontratën kolektive për faktin se paditësit nuk kanë ofruar prova se nga cili relacion udhëtojnë dhe në çfarë kohe, por kanë ofruar vetëm dy bileta të autobusit.

Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borxhit lidhur më këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi që palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datën 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, dhe po ashtu janë njoftuar kryetarët e komunave. Po ashtu MAPL ka bërë njoftimin për kryetarët e komunave për shkëputjen e kësaj kontrate.

Ka shtuar se meqenëse kjo kontratë më nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT, atëherë Komuna e Malishevës dhe DKAE nuk kanë legjitimitet të palës aktive në procedurë, por këtë legjitimitet e ka MASHT.

Në fund i ka propozuar gjykatës që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës-MASHT.

Provat e administruara dhe vlerësimi i tyre

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i ka shqyrtuar këto prova dhe atë:

Për paditësen L. M.-P.: vërtetimet e punësimit nr.... të datës 24.03.2021 dhe nr.3370/23 të datës 11.10.2023, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B ...të datës 04.03.2021, biletat e udhëtimit/kuponët fiskal të lëshuar nga N.SH.T. "Topallli" dhe "Mendi Tours" dhe kopja e letërnjoftimit.

Për paditësin R. P.: vërtetimet e punësimit nr.... të datës 24.03.2021 dhe nr.... të datës 11.10.2023, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B ... të datës 26.02.2021, biletat e udhëtimit/kuponët fiskal të lëshuar nga N.T.SH. "Lumi Reisen" dhe kopja e letërnjoftimit.

Për paditësen S. P.: vërtetimet e punësimit nr.2902/21 të datës 24.03.2021 dhe nr.... të datës 11.10.2023, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B ... të datës 16.03.2021, biletat e udhëtimit/kuponët fiskal të lëshuar nga N.T.SH. "Lumi Reisen" dhe kopja e letërnjoftimit.

Për paditësen D. P.: vërtetimet e punësimit nr.2908/21 të datës 24.03.2021 dhe nr.... të datës 11.10.2023, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B... të datës 03.03.2021, biletat e udhëtimit/kuponët fiskal të lëshuar nga N.T.SH. “Mendi Tours” dhe N.SH.T. “Topalli” dhe kopja e letërnjoftimit dhe

Për paditësin A. S.: vërtetimet e punësimit nr.2908/21 të datës 24.03.2021 dhe nr.... të datës 11.10.2023, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B ... të datës 04.03.2021, biletat e udhëtimit/kuponët fiskal të lëshuar nga kombi taxi “Nebih Krasniqi” dhe kopja e letërnjoftimit.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura dhe atë: L. M.-P. mësimdhënëse e programit fillor, R. P. mësimdhënës i lëndës së historisë, S. P. bibliotekare dhe mësimdhënëse e gjuhës shqipe, D. P. mësimdhënëse e programit fillor dhe A. S. mësimdhënës i lëndës së fizikës, që të gjithë të punësuar në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, shkollë kjo e cila bie në kompetencë të të paditurës dhe kjo është vërtetuar me vërtetimet e lartcekura.

Po ashtu nga vërtetimet e cekura më lart të lëshuara nga Drejtori i shkollës, për periudhën 2017 deri 31.12.2020, është vërtetuar fakti se: paditësja L. M.-P. i ka gjithsej 545 ditë pune, paditësi R. P. i ka gjithsej 545 ditë pune, paditësja S. P. i ka gjithsej 414 ditë pune, paditësja D. P. i ka gjithsej 133 ditë pune dhe A. S. i ka gjithsej 545 ditë pune.

Gjatë analizimit të biletave të udhëtimit-kuponëve fiskal të lëshuara nga kompanitë e udhëtimit është vërtetuar fakti se paditësit L. M.-P., R. P., S. P. dhe D. P. kanë udhëtuar në relacionin D.-Malishevë dhe anasjelltas, dhe për të shkuar në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, kanë shpenzuar nga 1 euro për biletë ditore në të dy drejtimet (0.50 euro në një drejtim), kurse paditësi A. S. ka udhëtuar nga vendbanimi i tij, pra në relacionin Janqishtë-Malishevë dhe anasjelltas, dhe ka shpenzuar nga 2 euro.

Në bazë të dokumenteve-certifikatave të vendbanimit të lëshuara nga zyra e gjendjes civile në Malishevë dhe kopjeve të letërnjoftimit, vërtetohet se paditësit L. M.-P., R. P., S. P., D. P. vendbanimin e kanë në fshatin D./ Malishevë, kurse paditësi A. S., vendbanimin e ka në fshatin J., komuna e Malishevës.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vërtetimet lëshuara nga e paditura të cekura më lart, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të

lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, vërtetimeve me të cilat është konstatuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe ditët e punës nga viti 2017-2020, gjykata ua falë besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Sipas nenit 8 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve “*Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*” ndërsa në dispozita e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë*”, kurse me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit u vendos që të njëjtën ta aprovoj për periudhën e kërkuar nga viti 2017 deri 2020 gjatë së cilës paditësit kanë punuar tek e paditura, fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura dhe në këtë gjendje të vërtetuar faktike, e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, ku me nenin 35 paragrafi 5 përcaktohet se: “*Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së caktuar, i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban*”.

Lidhur me këtë, gjykata ka vlerësuar se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë e aprovuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e bazuar edhe me dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “*I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”, pastaj nenit 90 par.5: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, dhe po ashtu lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku me nenin 3 paragrafi 2 përcaktohet se: “*I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate*”.

Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit (KKA) për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 - 21.01.2021 kurse të KKA të vitit 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 - 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Duke u nisur nga fakti se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj që del nga po e njëjta kontratë kolektive, përkatësisht neni 35 par.5, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në rastin konkret gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Sa i përket lartësisë së shumës, gjykata u bazua në biletat e udhëtimit/kuponët fiskal me anë të të cilëve vërtetohet se paditësit kanë udhëtuar nga vendbanimi i tyre për në vendin e punës ashtu që vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën 2017 deri me 31.12.2020 për ditët e punës, paditësve iu takojnë shpenzimet për udhëtim në shumën e përgjithshme prej 1,908.90 euro dhe atë për çdo ditë pune nga 70% të biletës. Pra, në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve t’ua paguaj shpenzimet e udhëtimit për ditët e sa kanë qenë prezent në punë.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadia e paditësve. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, është e pabazuar sepse e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve (mësimdhënësve) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk kanë mbështetje ligjore, për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, kurse Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datës 27.02.2023.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo ka vlerësuar se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe sikurse është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (14.05.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -II- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: “Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”, si dhe në bazë të rregullores për tarifat e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumën e përgjithshme prej 342.00 euro dhe atë: në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 312.00 euro (sipas numrit tarifar 6 të rregullores për tarifat e avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri ne 10.000 € - për pesë paditës) dhe shumën prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore (sipas tarifës së taksave gjyqësore 1,001.00 deri 2,500.00 euro – taksa gjyqësore është 30.00 euro),

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.360/2021, datë 13.05.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.